

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj-kryetar i kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Zenel Leku, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Drita Maloku Pukaj, në çështjen juridiko kontestimore të paditësve B.Z., L.Z. dhe B.Z., që të gjithë nga Shkupi, të cilët sipas autorizimit të përfaqëson A.I., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve " NN", me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi nga baza e auto përgjegjësisë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.128/11, i datës 09.10.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.09.2017 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I. VERTETOHET pika I dhe IV e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.128/11 i datës 09.10.2013, dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve " NN" me seli në Prishtinë, lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë refuzohet si e pabazuar.

II. Pika II dhe III e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, C.nr.128/11 i datës 09.10.2013, mbetet e paprekur (pashqyrtuar).

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.128/11 i datës 09.10.2013, me pikën I të dispozitivit ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve B.Z. dhe L.Z. që të dy nga Shkupi, duke detyruar të paditurën Kompania e Sigurimeve " NN", me seli në Prishtinë që paditësve për vdekjen tragjike dhe të papritur të fëmijës së tyre dy muajsh të pa lindur, në fatkeqësinë e komunikacionit të datës 16.03.2010, në emër të dëmit jo material për dhimbjet shpirtërore, t'ua paguaj secilit shemën prej 3,000.00 (tremijë) euro, me kamatë si për mjetet e deponuara në banke pa destinacion të caktuar të afatizuara mbi një vit duke filluar prej dt.09.10.2013, e gjere në pagesën definitive. Me pikën II të dispozitivit padia e paditëses së mitur B.Z. nga Shkupi është pranuar si e tërhequr. Me pikën III të dispozitivit është refuzuar si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e gjykuara. Dhe me pikën IV të dispozitivit është detyruar e paditura

qe paditësve qe t'ua paguaj shumat si ne pikën I të dispozitivit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 698.00 euro, ne afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes se aktgjykimit ne dorëzim, e nen kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e goditur për shkak të shkeljes se dispozitive te procedurës kontestimore dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësve B.Z. dhe L.Z. te refuzohet ne tërësi si e pabazuar.

Paditësit nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore dhe pretendimet nga përgjigja në ankesë e në kuptim të nenit 194, 195 dhe 201 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit përmes të autorizuarit të tyre, në gjykatën e shkallës së parë më datë 18.05.2011, kanë paraqitur padi kundër të paditurës , të cilën se fundi herë e kanë precizuar ne procesverbalin e seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 09.10.2013, më kërkesën qe gjykata pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit kryesor, përmes administrimit dhe vlerësimit të provave të propozuara, te detyroj te paditurën qe në emër të zhdëmtimit të dëmit jo material, e nga baza e auto përgjegjesisë, paditësve B.Z. dhe L.Z., për dhimbjet shpirtërore të cilat i kanë pësuar nga humbja e fëmiut të tyre të pa lindur (dy muajsh) në aksidentin e ndodhur më datën 16.03.2010 ne magjistralen Hani i Elezit-Ferizaj, i cili është shkaktuar me fajin e të siguruarit të paditurës, secilit prej tyre t'ua paguaj shumën prej 5,000.00 (pesëmijë) euro.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën zhvilloi procedurën dhe administroi provat nga shkresat e lëndës ku pas analizimit dhe vlerësimit të tyre, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar më për afërsisht si në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, në bazë të së cilës gjendje faktike duke zbatuar normat e së drejtës materiale, mori aktgjykimin e atakuar C.nr.128/11, i datës 09.10.2013, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitivin e të njëjtit.

Lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar , gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në bazë të provave shkresore të administruara, të cilave gjykata ju ka falur besimin janë bërë jokontestuese faktet, se më datën 16.03.2010 në orën 14:30 ne magjistralen Hani i Elezit-Ferizaj te vendi i quajtur " Ura e Kashanit", kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit ne të cilin ishin të përfshirë vetura e markës " Ford Fiesta" me

targa të regjistrimit 180-KS-908, të cilën e drejtonte i siguruari i të paditurës Naser Berisha nga Hani i Elezit dhe vetura e markës "Audi" A4 me targa të regjistrimit SK-395-TE të cilën e drejtonte paditësi B.Z.. Gjer tek aksidenti i ndodhur ka ardhur me lëshimet ekskluzive të te siguarit të paditurës i cili duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së veturës me kushtet në rrugë, nuk arrin që të ndalet prapa automjetit të paditësit i cili në ato momente ishte i ndalur para semaforit të përkoreshëm i cili ishte i vendosur në rrugë me ç'rast me pjesën e përparme të automjetit të tij e godet në pjesën e pasme të veturës së paditësit, në të cilën shkaktohen dëme të konsiderueshme materiale, ndërsa lëndime trupore pëson paditësja L.Z., e cila si shkak i lëndimeve të marra kishte humbur fëmiun e saj të pa lindur (embrionin) në javën e tetë të shtatzënisë së saj.

Se aksidenti kishte ardhur me lëshimet ekskluzive të te siguarit të paditurës këtë fakt gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në bazë të raportit të policit hetues, skicës së vendit të ngjarjes, dhe ekspertizës së komunikacionit e punuar në procedurën penale nën nr.PP.nr.416/10 e datës 26.04.2010, nga Ing. i komunikacionit Flamur Salihu të cilave gjykata iu ka falur në tërësi besimin. Se në aksidentin e ndodhur paditësja L.Z. kishte pësuar lëndime trupore, ku si pasojë e këtyre lëndimeve edhe kishte abortuar foshnjën e saj (embrionin) në javën e tetë të shtatzënisë, këtë fakt gjykata e shkallës së parë e ka provuar nga raporti mjekësorë i QKMF, në Kaçanik i datës 16.03.2010, si dhe nga dokumentacioni mjekësorë nga shkresat e lëndës i lëshuar nga Klinika Universitare në Shkup, vërtetimi i datës 09.04.2010, raporti mjekësorë i Klinikës së Psikiatrisë në Shkup, fletë lëshimi nga Banja e Kllokotit, mendimi i gjinekologut Kadri Zhuta, i datës 25.01.2011., të te cilave prova gjykata ju ka falur në tërësi besimin

Mbi bazën e këtyre fakteve të vërtetuara, gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se në kuptim të nenit 154 të LMD-së, ekziston detyrimi ligjor i të paditurës, që paditësit në emër të dhimbjeve shpirtërore të cilat i kanë pësuar si shkak i humbjes së fëmiut (embrionit) të ju paguan kompensim të drejtë në të holla.

Lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë së paditësve, gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit kryesor ka nxjerrë provën me ekspertim nga lëmia e neuropsikiatrisë, ku ekspertja e kësaj lëmie Dr.Nazmie Musliu në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 20.09.2013, pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë bërë paditësve dhe vlerësimit edhe të dokumentacionit mjekësorë, ka konstatuar se paditësja L.Z. si shkak i humbjes së embrionit në aksidentin e ndodhur ka pësuar dhimbje shpirtërore të cilat fillimisht janë manifestuar me reagime të natyrës emocionale të te qarave të herë pas hershme, shqetësimeve gjatë gjumit, rënies së disponimit dhe të vullnetit të përgjithshëm, e që kanë qenë të një intensiteti më të lartë të manifestimit në një periudhë prej dy muajve, për çka është konsultuar edhe psikiatri bazuar në raportin e datës 15.04.2010, i lëshuar nga Klinika e Psikiatrisë në Shkup. Kjo dhimbje shpirtërore është prezentë edhe sot e asaj dite e që shoqërohet me manifestime të një intensiteti më të ulët të shoqëruar me reagime të herë pas hershme emocionale, e sidomos në situata ku ballafaqohet me procedurat e

diagnostifikimit dhe trajtimit gjinekologjik, bisedave që kanë të bëjnë me temën e drejtpërdrejtë të humbjes, mendimeve të herë pas hershme depressive, si dhe brengës për të ardhmen e sajë sa i përket mundësisë për një shtatzëni të serishme. Gjatë kësaj periudhe paditëses i është rekomanduar nga ana e psikiatres trajtimi dhe aplikimi i terapisë psikofarmakologjike, si dhe intervenimi psikiatrik që nënkupton konsultat e herë pas hershme me profesionist të shëndetit mendor. Ndërsa sa i përket paditësit B.Z. i njëjti ka përjetuar dhimbje shpirtërore për shkak të humbjes së embrionit të cilat kanë qenë të manifestuara me një intensitet të lartë të manifestimit që kanë zgjatur për një periudhë kohore prej dy javësh, e shoqëruar me reagime tërësisht të natyrës emocionale, shqetësimeve të herë pas hershme neurotike, si dhe vështirësive të trajtimit që kanë shoqëruar gjatë kësaj periudhe bashkëshorten e tij L.Z.. Këto dhimbje shpirtërore janë sot e asaj dite që manifestohen me një intensitet më të ulët e që shoqërohen me nervozë të herë pas hershme, stresit kronik dhe ngarkesës emocionale sidomos gjatë periudhave të kontrollave apo vizitave mjekësore e diagnostike që bënë bashkëshortja e tij dhe që ende nuk kanë gjetur një zgjidhje sa i përket shtatzënisë së ardhshme ku është një brengë e vazhdueshme sa i përket të ardhmes dhe trashëgimisë së tyre.

Lidhur me caktimin e lartësisë për shumatat e gjykuara paditësve, gjykata e shkallës së parë është referuar dhe ka aplikuar dispozitën ligjore të nenit 201 al. 1 të LMD-së, duke vlerësuar se shumatat e gjykuara paraqesin një shpërblim të drejtë duke marrë për bazë rëndësinë e shkeljes se të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi për raste të tilla.

Vendimin mbi kumatën e gjykuar, gjykata e ka bazuar në dispozitën ligjore të nenit 277 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e ka bazuar në dispozitat ligjore të nenit 449, 452.1 dhe 453 të LPK-së, e duke marrë për bazë shpenzimet të cilat paditësve u janë krijuar për ndjekjen e çështjes se tyre në gjyq dhe suksesin e palëve në procedurën e udhëhequr.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës lidhur më mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar në pjesën aprovuese të kërkesëpadisë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike del të jetë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe plotësisht, ku janë dhënë edhe arsye të mjaftueshme lidhur më faktet vendimtare rreth mënyrës së vendosjes të cilat kanë mbështetje të plotë në provat shkresore dhe në ligj.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar në pjesën që ka të bëjë më kompensimin e dëmit jo material për dhimbjet fizike të cilat paditësit i kanë përjetuar si shkak i humbjes së fëmiut të tyre të pa lindur (embrionit). Kjo për faktin se shumatat e gjykuara paditësve

për këtë kategori të dëmit jo material, janë në përputhje të plotë me natyrën e shpërblimit kur kihet parasysh rëndësia e shkallës së të mirës e cila u është cenuar në aksidentin e ndodhur dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim siç është paraparë me dispozitën e nenit 201 paragrafi 1 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve ( LMD). Shpërblimi në të holla i kësaj kategorie të dëmit jo material nuk është qëllim, por mjet më të cilin të dëmtuarit , këtu paditësve do te ju mundësoj qe deri diku të zbusin pasojat e dhimbjeve fizike të përjetuara, te cilat sigurisht qe përbëjnë një përjetim të pakëndshëm dhe të paharrueshëm gjatë jetës se tyre, me çka shpërblimi në të holla paditësve do tu shërben si satisfaksion moral dhe si një përjetim i këndshëm, për zbutjen e pasojave të shkaktuara duke i kënaqur disa nevoja të caktuara jetësore.

Shumat e gjykuara për këtë lloj dëmi sipas vlerësimit të gjykatës janë në përputhje të plotë edhe me shkallën dhe mënyrën e manifestimit të dhimbjeve shpirtërore të cilat i kanë përjetuar paditësit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, brengat dhe pasojat e mundshme sa i përket shtatzënisë së ardhshme të paditëses L.Z., mënyrën e humbjes se fëmiut të tyre, moshën e paditësve , por edhe rrethanat tjera të cilat kanë ndikim për vendosje për një kompensim të drejtë në të holla. Shumat e gjykuara janë në përputhje të plotë me rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, duke mos favorizuar për asnjë moment synimet qe nuk përkojnë me natyrën dhe qëllimet për të cilat shërben ky shpërblim.

Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ne harmoni me dispozitat ligjore ne fuqi del te ketë vendosur edhe sa i përket kamatës ne shumat e gjykuara e cila është ne përputhje me dispozitat e ligjit material i cili ka qenë ne fuqi ne kohën kur ka ndodhur aksidenti, si dhe lidhur me shpenzimet procedurale të njohura paditësve, të cilat janë në përputhje të plotë me shpenzimet e nevojshme të cilat i kanë pasur paditësit për ndjekjen e çështjes se tyre ne gjyq, dhe ne përputhje te plotë me tarifën e Odës se Avokatëve e cila ka qenë ne fuqi në kohën e marrjes se aktgjykimit nga ana e gjykatës se shkallës së parë, ku e paditura si palë e cila ka humbur procesin gjyqësor dhe palë e cila i ka dhënë shkas procedurës, ka për detyrim ligjor qe paditësve t'ua paguaj të gjitha shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës se udhëhequr.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK, me arsyetimin se dispozitivi është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin, , sipas Gjykatës së Apelit të Kosovës është pretendim i pathemeltë për faktin se sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar del te jetë mjaft i qartë dhe i arsyetuar mirë si në pjesën e dispozitivit ashtu edhe atë të arsyetimit, ku i njëjti përmban të gjitha elementet e kërkuara ligjore sipas dispozitës së nenit 160 të LPK.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i ankimuar është marrë me zbatim të gabuar të se drejtës materiale, me arsyetimin se me nenin 201 të LMD-së, e drejta ne kompensim anëtarëve të familjes ju takon vetëm ne rast te vdekjes se ndonjë personi, e jo

edhe për humbje të frutit (embrionit), e aq me pak paditësit B.Z. i cili ligjërisht mund të konsiderohet si baba i supozuar, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës është pretendim i pathemeltë për arsyet si ne vijim.

Atësia e një fëmiu i cili pritet të lindë në çdo rast është supozim, por i cili mund të rrëzohet vetëm nëse provohet e kundërta. Në rastin konkret është e pamundur të provohet e kundërta, por edhe po të ekzistonte mundësia e të provuarit, e paditura nuk do të ishte e legjitimuar për të dhënë një kundërshtim të tillë. Nga një rrethanë e tillë duke marrë për bazë edhe faktin se në bazë të certifikatës së martesës me nr. rendor 1003-2/262 e datës 18.03.2011 e lëshuar nga Komuna e Shkupit, Republika e Maqedonisë, rezulton se paditësit janë të martuar (bashkëshortë), atëherë rrjedhimisht i bie që paditësi edhe ligjërisht do të ishte at i fëmiut, i cili pritej tu vinte në jetë paditësve, derisa të mund të vërtetohej e kundërta e kësaj

Dispozita nga neni 201 parg 1 i LMD-së, në këtë rast duhet të aplikohet me analogji si në rastin kur pranohet kompensimi i të afërmeve për anëtarin e humbur të familjes. Gjykata e Apelit të Kosovës vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet e aplikimit të dispozitës me analogji, sepse edhe në raste tjera fëmiut i cili ende nuk ka lindur i njihen të drejtat me kusht që të lindë i gjallë (si psh. në trashëgimi). Në rastin konkret është vlerësim i kësaj gjykate që gjasat do të ishin të plota që fëmija (fetusi) të lindë i gjallë nëse nuk do të ndodhte aksidenti i trafikut i cili është shkaktuar me fajin e të siguruarit të paditurës, ngase në shkresat e lëndës ekzistojnë dëshmi që e dëmtuara, këtu paditësja L.Z. ka qenë në gjendje të rregullt shëndetësore, ku rrjedhimisht lënë për tu kuptuar se edhe fetusi ka qenë në gjendje të rregullt shëndetësore. Po ashtu nuk kanë ekzistuar asnjë nga r

Pika II dhe III e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, nuk janë shqyrtuar nga ana e gjykatës ankimore pasi që nuk janë atakuar nga pala ankuese.

Prandaj, nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4148/13, datë 07.09.2017

Kryetari i Kolegjit,

Qerim Ademaj